ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-24-5210-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me lëndë djegëse dru dhe pelet për ngrohje për nevojat e Institucioneve Arsimore të Komunës së Prizrenit për vitin shkollor 2024 2025**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" AMBIENTI " SH.P.K.**
NUI	**601279707**
Adresa	**Prishtine, Mati 1, Rruga B, Obj. Inxhiniering, H 2, Nr 2.**
Vendi	**Kosove, Prishtine**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Erona Thaqi**
Adresa elektronike	**shpk.ambienti@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**05.07.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me lëndë djegëse pelet për ngrohje për nevojat e Institucioneve Arsimore të Komunës së Prizrenit për vitin shkollor 2024 2025

Njoftimi për Kontratë: 27.05.2024

Lloji i kontratës: Furnizim

FPP: 02190000-2 Lende druri

Lloji i procedurës: Procedurë e hapur

Vlera e parashikuar: 575,000.00

Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje: 08.07.2024 14:00

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim: 02.07.2024

Vendim për kërkesën për rishqyrtim: 03.07.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë dispozitat e mëposhtme të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik si dhe Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik.

Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik - *Legjislacioni primar*
Neni 1 - Qëllimi
Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 27 - Dosja e tenderit
Neni 27/A - Ndarja e kontratave në Lote

Neni 28 - Specifikimet teknike
Neni 108/A - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurimin Publik - *Legjislacioni sekondar*
Neni 13 - Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës
Neni 17 - Dosja e tenderit
Neni 18 - Ndarja e kontratave në Lote
Neni 19 - Specifikimet teknike

Udhëzuesi Nr.001/2023 për Prokurimin Publik - *Legjislacioni sekondar*
Neni 3 - Klasifikimi i kontratave publike sipas vlerës
Neni 4 - Ndarja e kontratave në Lote
Neni 5 - Specifikimet teknike

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Të pa kënaqur me kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë, konform Nenit 109 të Ligjit për Prokurimin Publik në afatin e lejuar ligjor bazuar edhe në Nenin 60 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, paraqesim këtë "Ankesë" ndaj aktivitetit

të prokurimit me titull ***"Furnizim me lëndë djegëse dru dhe pelet për ngrohje për nevojat e Institucioneve Arsimore të Komunës së Prizrenit për vitin shkollor 2024 2025"*** me nr.prokurimi 622-24-5210-1-1-1 e inicuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit.

Për shkak se: Kuvendi Komunal i Prizrenit

Në mënyrë të kundërligjshme ka vendosur kërkesa dhe kritere për aktivitetin e prokurimit me të dhënat e lartëcekura, AK kërkesat e vendosura në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit të përshkruara edhe me rregullat përmbajtësore në Aneksin 1 tek Specifikimet teknike të detyrueshme ka ra në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sqarojmë në mënyrë të detajuar:

Me datën 02.07.2024 si palë e interesit konform Nenit 4.1.26 të LPP-së kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues "Kuvendi Komunal i Prizrenit", me datën 03.07.2024 ky Autoritet e hedh poshtë si të jashtë-afatshme kërkesën tonë me pretendim se nuk e kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afatit të lejuar kohor konform rregullave dhe dispozitave ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në bazë të Nenit 108/A të LPP-së.

Supozohet se Autoriteti Kontraktues me rastin e përgatitjes së Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me të dhënat e lartëcekura ka vepruar në kundërshtim me Legjislacionin primar dhe sekondar të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës i cili aktualisht është në fuqi.

Me datën 27.05.2024 ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe dosjen e tenderit në platformën e E-prokurimit, duke mos dhënë detaje të mjaftueshme dhe informata të mangëta tek Aneksi 1 - Specifikimet teknike të Detyrueshme ku këto kërkesa në kundërshtim me ligjet aktuale në fuqi të Prokurimit Publik.

Neni 25.5 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: ***"Kriteret e përzgjedhjes do të specifikohen qartë në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe, çdo dokument apo informatë tjetër që OE i interesuar kërkohet të dorëzoj në mënyrë që të konsiderohet i kualifikuar".***

Njoftim fillestar: Autoriteti Kontraktues: Kuvendi Komunal i Prizrenit këtë aktivitet të prokurimit me vite rradhazi e shpërblen me kontratë të njejtin operator ekonomik si fitues të kontratës, gjë që ka pasur edhe informacione e lajme të publikuara edhe në gazetat dhe mediumet online në lidhje me afërsin e zyrtarit të prokurimit dhe operatorit ekonomik fitues, gjë që flitet paraprakisht edhe përgatitja dhe kurdisja e këtij tenderit për të njejtin operator ekonomik si për nga kriteret ashtu edhe nga operatorët ekonomik e tjerë që merren me këtë veprimtari duke shkelur edhe parimet e konkurrencës së lirë poashtu veprojnë edhe në kundërshtim me Ligjet aktuale në fuqi, dhe marrin veprimet për të kryer vepër penale të kurdisjes dhe lidhjes së marrëveshjeve ndërmjet vehte duke ndarë regjionet se cila kompani cilin regjion obligohet ta mbaj, gjë që për këto veprime do ta informojmë edhe Autoritetin e Konkurrencës (për të cilat disponojmë edhe materiale e prova), nga i cili Autoritet do të kërkojmë mbrojen e konkurrencës. Ne si operator ekonomik i interesuar për këtë kontratë konform Nenit 4.1.26 të LPP-së pos ndjekjes së të

gjitha rrugëve ligjore sipas rregullave dhe dispozitave ligjore do të mbajmë edhe të informuar të gjitha organet tjera të drejtësisë dhe OJQ-të, shoqërinë civile dhe mediumet online lidhur me ecurin dhe procedurat që do të ndiqen deri në rezultatin final dhënien e kësaj kontrate.

Sipas Nenit 1 të LPP-së, *Qëllimi i këtij ligji është që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfyrtëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla*.

Nga po e njejta dispozitë ligjore thuhet se ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

Me rastin e vendosjes së kërkesave dhe kritereve në Dosjen e tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur parasysh edhe Nenin 7 të LPP-së, kështu që kufizon konkurrencën për të ia lehtësuar "dostit" të vetë fitimin e këtij tenderit duke i kufizuar operatorët tjerë ekonomik, me vendosjen dhe shfrytëzimin e një vakumi ligjor duke kufizuar operatorët ekonomik që në raste të krijimit të grupit të operatorëve ekonomik, lideri duhet të përmbush 60% të kërkesave të përcaktuara në bazë të Nenit 68 dhe Nenit 69 të LPP-së.

Andaj konsiderojmë se një kërkesë e till është në kundërshtim me Nenin 7.2 të LPP-së ku thuhet: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".

Autoriteti Kontraktues fillimisht edhe për kundër Njoftimit të publikuar për korrigjimin e gabimeve, Dosjen e tenderit dhe Njoftimin për Kontratë nuk e ka identike, ashtu siq e parasheh edhe Neni 27 par.4 i LPP-së, dhe Neni 17.12 i RrPP-së ku thuhet: "Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike."

Në Dosjen e tenderit dhe Njoftimin për Kontratë nuk përputhen disa nga të cekurat e kërkesave.

Kërkesa tjetër e vendosur si në pikën nr.2 pika b) lidhur me të punësuarit me profile të ndryshme që poashtu është kufizuar për "rahatimin e dostit" duke kërkuar që në raste të grupit të operatorëve ekonomik, lideri i grupit të ketë 60% të numrit të kërkuar të të punësuarëve.

Kërkesa e AK-së në lidhje me stafin e angazhuar ku ka cekur se duhet të ketë minimum 7 të punësuar është në kundërshtim me Nenin 8.5 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, si dhe Nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik; Në faqen nr.25 të Udhëzuesit të lartëpërmendur në pikën c) dhe d) në rast të kontratave për ofrimin e shërbimeve dhe furnizimeve ceken se Autoritetet Kontraktuese duhet të vendosin si kërkesë: minimumin e mesatares duke mos kufizuar në numër kërkesën e punëtorëve/personelit që duhet angazhuar. Kjo kërkesë mendojmë se është favorizuese në njërën anë dhe diskriminuese në anën tjetër. **Andaj kërkojmë me mirëkuptim kërkesatë ndryshohet kërkesa dhe numri i kufizuar të largohet.**

Andaj për përdorim të drejtë të fondeve publike konform Nenit 1 dhe Nenit 6 të Ligjit për Prokurimin Pulik besojmë se duhet të largoni kërkesat kufizuese në mënyrë që të keni konkurrencë në këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë specifikim teknik të detyrueshëm edhe pse jeni të obliguar që në bazë të Ligjit të formuloni specifikat e nevojshme për aktivitetin e prokurimit.

Neni 44.2 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: ***"Përdorimi i formularëve standard" do të thotë se dokumentet e prokurimit duhet të përmbajnë të paktën të gjitha informatat, kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përcaktuara në formularët standard si informacion të detyrueshëm, dhe në përgjithësi të jenë të qartë dhe të kuptueshme për OE të interesuar".***

Neni 19.3 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: "Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, përformanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimit. AK do të tregojë nëse specifikimet teknike të specifikuara janë obligative apo kërkesa minimale".

Aneksi 1 specifikimet teknike janë të mangëta, AK është dashur që neve (operatorëve ekonomik) të na tregon më detajisht lidhur me kërkesat e vendosura tek Aneksi 1 pasi që Specifikimet teknike siq e cekëm nuk ka.

Neni 7.4 i LPP-së thotë: ***"Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik".***

Neni 19.4 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: ***"Përshkrimi i specifikimeve teknike/Termat e referencës do të jenë të qarta, sakta dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të pa arsyeshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Specifikimet duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë paqartësi rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara".***

Kërkesat e vendosura nga AK nuk janë në harmoni as me legjislacionin primar e as sekondar të Ligjit për Prokurimin Publik në lidhje me operatorët e rinj ekonomik të sapo formuar, AK ka vendosur kërkesa diskriminuese. Kërkesat e AK-së nuk janë minimale për kualifikim dhe nuk janë të drejtëpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Në faqe nr.11 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik keni këtë në pikën 3.7: *Shënim: Informatat obligative të kërkuara gjatë kompletimit të Dosjes së Tenderit dhe të specifikuara në tabelën më lartë janë të përfshira edhe ne RrPP, por të cilat janë përsëritur edhe në këtë udhëzues në mënyrë që AK-se të udhëzohen t'i kenë parasyshë gjatë përgaditjes së Dosjes së Tenderit, gjithmonë duke shmangur përgaditjen e DT në një mënyrë që favorizon ose diskriminon një ose më shumë Operatorë Ekonomik potencial.*

Dispozitat ligjore në vijim si: Neni 25.4 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: "Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, ***AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike***. "Të arsyeshme dhe të mjaftueshme" do të nënkuptoj në lidhje me: a. vlerën e parashikuar të kontratës, dhe b. përdorim të drejtë të fondeve publike"

Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) ku Qëllimi i këtij neni është që Autoriteti Kontraktues t'i trajtoj në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik dhe jo në mënyrë diskriminuese dhe poashtu të veproj në mënyrë transparente, duke larguar kërkesat kufizuese dhe jo ligjor të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Neni 25.6 i Rregullores së Prokurimit Publik thotë: **"Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë".**

Me ç'rast kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që pas elaborimit të të gjitha pretendimeve tona ankimore në lidhje me shkeljet e supozuara të dispozitave ligjore që janë në fuqi, të nxjerr:

VENDIM

1. APROVOHET si e bazuar ankesa jonë për rishqyrtim në lidhje me aktivitetin e prokurimit dhe

2. KORRIGJOHET njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit e AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Ofertues në këtë aktivitet të prokurimit kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit (ofertës) dhe pjesëve të tjera të cilat ndërlidhen me këtë procedurë të prokurimit si: shpenzimet për përgatitjen e ankesave si në fazën e parë dhe atë të dytë, përfaqësimeve të cilat ndodhin etj.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material e i cili shtrihet edhe në raport me Neni 136 dhe Neni 137 të LMD-së duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*